

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TË POLITIKAVE DHE PROGRAMEVE TË ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Nr. 918/16 Prot.

Tiranë, më 11.04.2024

Lënda: Përcillet urdhër /vendimi i përbashkët për miratimin e tekstit mësimor për diasporën

QENDRËS SË BOTIMEVE PËR DIASPORËN

Rruga "Vilat Gjermane", Vila nr.6

Tiranë


Bashkëlidhur gjeni Urdhër/Vendimin e përbashkët "Për miratimin e tekstit mësimor për diasporën "Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare", Niveli II", me nr.918.prot., datë 02.02.2024 dhe nr.018/023.prot., datë 11.03.2024, përcjellë me shkresën e Kabinetit të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, më datë 28.03.2024, regjistruar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, me nr. 918/5prot., datë 02.04.2024.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministres / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

Prishtinë, 28.03.2024


I/e nderuar,

Në vijim të nënshkrimit të Urdhër-Vendimit të përbashkët për miratimin e tekstit mësimor për Diasporën, “Gjuha Shqipe dhe kultura Shqiptare” Niveli II nga Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës (MASHTI), znj. Arbërie Nagavci, dhe Ministrja e Arsimit dhe Sportit e Shqipërisë (MAS), znj. Ogerta Manastirliu, ju lutem gjeni të bashkangjitur kopjen origjinale të Urdhër-Vendimit, të nënshkruar dhe protokolluar.

Me respekt,

Bora Shpuza

Shefe e Kabinetit të Ministres, MASHTI




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Nr. 918 Prot.

Datë 02.02.2024

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLICA OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES - VLADA KOSOVO - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCES DHE E TEKNOLOGJISE MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVES - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org.	Nr. Prot:
Org. Jedinica	Org. Prot:
Org. Upr.	Prot. No:
Nr i faqeve	Datum:
Br. stranic	Detum:
No. pages	Date:

Printime: 1



Republika e Kosovës

Republic of Kosovo - Republika Kosova
Qeveria - Government - Vlada

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation /
Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija

Nr. 018/023 Prot.

Datë 11.03.2024

URDHËR/VENDIM I PËRBASHKËT

PËR

MIRATIMIN E TEKSTIT MËSIMOR PËR DIASPORËN “GJUHA SHQIPE DHE KULTURA SHQIPTARE”, NIVELI II

Me propozim të Komisionit të Përbashkët Shqipëri - Kosovë për Miratimin e Teksteve të Mësimore për Diasporën, në zbatimin të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të datës 23.03.2015, “Për organizimin e përbashkët të mësimin të gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe mërgatë”, lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës, dhe bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.9.2020, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve të Përbashkëta për Diasporën”:

URDHËROJMË/ VENDOSIM:

1. Miratimin e tekstit mësimor për diasporën “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare” niveli II, i shtëpisë botuese “Albas” dhe shtëpisë botuese “Dukagjini”, i renditur i pari në listën fituese të konkursit për tekstin mësimor për mësimin plotësues në diasporë dhe në mërgatë.

2. Shtëpia botuese “Albas” dhe shtëpia botuese “Dukagjini” të përmbushin detyrimet e botimit për tekstin mësimor në diasporë “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli II, të kërkuara nga ministritë përgjegjëse të të dy vendeve.
3. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë, si dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës së Kosovës, Komisioni i Përbashkët Shqipëri - Kosovë për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër/vendim i përbashkët hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

OGERTA MANASTIRLIU

**MINISTRI I ARSIMIT, SHKENCËS,
TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT
REPUBLIKA E KOSOVËS**

ARBËRIE NAGAVCI